



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.149/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Afijete Sada - Gllgjani kryesuese, Faton Ademi dhe Adnan Konushevci anëtar, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bekteshi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes se posterit në hapësirë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahën me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 02.10.2019, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet** e bazuar ankesa Anr.149/2019 e datës 01.10.2019 e paraqitur nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), subjektit politik Partia Demokratike e Kosoves (PDK), i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej **2,800.00 €** (dymijetëqind euro), të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimi të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

Me datën 01.10.2019, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me të cilën pretendon se me datën 01.10.2019, në sheshin “Skënderbeu” në Prishtinë, monitoruesi ynë ka hasur në poster të kandidatit për deputet nga Partia Demokratike e Kosoves (PDK), i vendosur në hapsirë publike. Paraqitësi i ankesës më tutje thekson se subjekti politik PDK ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kosovës, perkatësisht nenin 33 pika b), si provë për pretendimet e tyre paraqitësi ka bashkangjitur një (1) fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), të datës 02.10.2019, ka theksuar se janë marrë masa përmiruese, ku është evituar shkelja për kandidatin Mërgim Lushtakut dhe kjo dëshmohet me fotografinë e bashkangjitur në përgjigje.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

### Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posterit i kandidatit për deputet nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosoves (PDK), është ngjitur në hapësirë publike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33 pika b), të LZP-së, e cila përcakton: *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe postereve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugë publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve”*.

Duke u nisur nga gjendja faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), është shkelur neni 33 pika b), të LZP-së, pasi që posteri i kandidatit për deputet nga subjekti politik (PDK), është vendosur në hapësirë publike.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjekti politik Partia Demokratike e Kosoves (PDK), ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se është njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër të këtij fakti posteri i kandidatit për deputet të këtij subjekti politik është vendosur në hapësirë publike.

Si rrethanë PZAP-i, morri edhe faktin që subjekti politik PDK në përgjigjen në ankesë, ka deklaruar se janë marrë masa përmirësuese, ku është evituar shkelja dhe kjo dëshmohet me fotografinë e bashkangjitur në përgjigje. Ndërmarrja e masave përmirësuese nga ana e subjektit në fjalë ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, PZAP-i në kuptim të nenit 120.1, pika c) dhe nenit 118 par. 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 149/2019 më datën 02.10.2019.

**Kryesuesja e Panelit**  
Afijete Sada Gillogjani

***Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së.***

